



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.07.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i procesverbalit.

Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale"

(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglantina Gjermani, Rrahman Rraja, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatjana Nurçe, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lefter Koka, Robert Bitri, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Benet Beci – drejtor i Fondit Shqiptar për Zhvillim

Tedi Bushaj – Ministria e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Përshëndetje, të nderuar kolegë deputetë!

Siç ju kemi vënë në dijeni, ditën e sotme do të shqyrtojmë në komision projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale”

Data e shqyrtimit në seancë parlamentare është 23 korrik.

Të ftuar nga Fondi Shqiptar për Zhvillim kemi zotin Beci.

Ju urojmë mirëseardhjen në komision!

Relator i projektligjit është z. Andrea Marto.

Zoti Marto flla për Ju.

Andrea Marto – Ky projekt është në kuadër të programit të 100 fshatrave dhe objektivat e tij lidhen me përmirësimin e aksesit në qendrat e përzgjedhura bujqësore dhe turistike. Gjithashtu edhe me forcimin e kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar asetet e tyre rrugore.

Deri sot kemi parë një braktisje të zonave rurale. Ky projekt do t’i rigjallërojë ato.

Eduard Shalsi – Fillimisht do të dëgjojmë përfaqësuesit e ardhur në komision. Më pas do të vazhdojmë me pyetjet, përgjigjet për to dhe në fund me komente dhe diskutime nga anëtarët e komisionit.

Jeni dakord me rendin e ditës?

Tedi Bushaj – Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për projektin e konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale, nëpërmjet akordimit të një huaje në shumën 50 milionë USD

Projekti i konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale është në kuadër të programit të 100 fshatrave dhe objektivat e tij lidhen me përmirësimin e aksesit në qendrat e përzgjedhura bujqësore dhe turistike, si dhe me forcimin i kapaciteteve të bashkive për të menaxhuar asetet e tyre rrugore.

"Programi i 100 Fshatrave" është programi i qeverisë shqiptare i miratuar me qëllim kthimin e 100 fshatrave në territorin e saj në modele të zhvillimit rural nëpërmjet një qasjeje të ndërhyrjes ndërqeveritare ndërinstitucionale për mundësimin e ndërhyrjeve zhvillimore në zonat rurale.

Projekti përbëhet nga 3 pjesë që janë:

Përmirësimi i aksesueshmërisë përmes rehabilitimit për t'i rezistuar ndikimeve klimatike dhe nismave për sigurinë rrugore;

Ndërtimi i kapaciteteve për bashkitë përmes ndërtimit të kapaciteteve bashkiake për të menaxhuar dhe mirëmbajtur rrjetet rrugore dhe ndërtimit të ekonomive të reja;

Mbështetja për menaxhimin e zbatimit përmes mbështetjes së Njesisë së Zbatimit të Projektit.

BERZH-i do t'i akordojë qeverisë shqiptare një shumë prej 50,000,000 dollarë amerikanë, për të ndihmuar për financimin e Projektit të konektivitetit të rrugëve rajonale dhe lokale

Huaja e akorduar nga BERZHI ka termat e mëposhtme:

Shuma e huasë është 50 milionë dollarë. Tarifa e parapagimit është një e katërta e një për qind (0.25%) e shumës së kredisë. Tarifa e angazhimit është një e katërta e një për qind (0.25%) në vit të Bilancit të Huasë së Patërhequr. Norma e interesit është Norma e Referencës, plus Shpërndarja Fikse. Datat e pagimit janë data 1 mars dhe 1 shtator e çdo viti.

Afati i fundit për tërheqjen e fondeve në kuadër të kësaj marrëveshjeje huaje është data 31 dhjetor 2022. Maturimi është 29.5 vjet duke përfshirë periudhën prej 6 vitesh pa pagesë principali.

Ky financim u pa i domosdoshëm për shkak të problematikave infrastrukturore dhe nevojës për përmirësim në rrugët lidhëse rajonale, potencialit turistik që kanë zonat e projektit, si dhe vlerësimit të prioriteteve të qeverisë shqiptare me fokus zhvillimin e infrastrukturës.

Benet Beci – Është një projekt pjesë e një projekti të përgjithshëm prej 150 milionë dollarësh. Do të vij në Parlament në dy paketa të ndryshme me dyc projektligje të ndryshëm.

Kemi marrë shumë vlerësime pozitive nga bashkitë. Nuk është vetëm një projekt tipik rural, por edhe turistik. Kemi edhe projekte të tjera të cilat paralelisht integrojnë infrastrukturën urbane, rurale dhe turistike në zona të ndryshme të Shqipëtrisë.

Eduard Shalsi – Kur mendohjet të ketë një pamje të qartë?

Benet Beci – Menjëherë në fillim të shtatorit do të kemi listën e investimeve.

Ilir Beqaj – Rrugë rajonale cilat quhen? Cili është përkufizimi “rrugë rajonale”? “Qendrat që do të përzgjidhen, apo “të përzgjedhura”?

Benet Beci – Po. Do të përzgjidhen.

Vullnet Sinaj – Unë do të doja një informacion rreth rrugës së Vlorës.

Eduard Shalsi – Ka pyetje të tjera?

A jemi gati për votim?

Hapim votimin për miratimin në parim.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 1?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E qartë.

Atëherë, duke ju përgëzuar, ju uroj punë të mbarë!

Të nderuar kolegë deputetë, ditën e mirë dhe mirupafshim!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA